



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 97, datë 28.10.2024

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 195, DATË 22.12.2023, “MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr.1, datë 24.1.2024, të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, si dhe sipas relacionit të për gatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondeve të shpenzimeve korrente dhe kapitale ndërmjet programeve buxhetore sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.10.2024



Tabela 1 - RISHPERNDARJA E FONDEVE PER SHPENZIME KAPITALE NDERMJET PROGRAMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2024

NE LEKE

Nr	Prog.	Kap	Art.	Kodi Inst	Njesia shpenzuese	Kodi Projektit	Emerfimi i Projektit	Shtese 2024	Pakesim 2024
1	04520	5	231	2107001	Bashkia Durrës	1071659	Rikonstrukcion i shëtitores Taulantia (segmenti nga Pista tek sheshi Sfinks)		8,000,000
2	04520	5	231	2107001	Bashkia Durrës	1071660	Mbikqyrje objekti "Rikonstrukcion i shëtitores Taulantia (segmenti nga Pista tek sheshi Sfinks) "		250,000
3	09120	5	231	2107001	Bashkia Durrës	1071587	Rikonstrukcion kopshiti ne fshatin Shkalle , NJA Manez		6,000,000
4	09120	5	231	2107001	Bashkia Durrës	1071588	<i>Mbikqyrje objektit "Rikonstrukcion kopshiti ne fshatin Shkalle , NJA Manez"</i>		113,000
5	09120	5	231	2107001	Bashkia Durrës	1071589	<i>Kolaudim objektit "Rikonstrukcion kopshiti ne fshatin Shkalle , NJA Manez"</i>		11,000
6	04910	5	609	2107001	Bashkia Durrës		Fondi rezervë		16,551,647
								-	30,925,647
7	06140	5	230	2107011	Bashkia Durrës	1071567	Studim projektim parku urban Spitalë	2,626,753	
8	04520	5	231	2107010	Bashkia Durrës		Shpronësim për interes publik te pasurive pronë private që preken nga realizimi projektit me objekt "Projektzbatimi për ndërtimin e shëtitores së plazhit të Durrësit, nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Konvaleshencës" sipas VKM nr.508 dt.1.8.2024	26,298,894	
9	01110	5	602	2107010	Bashkia Durrës		Shperblimi i këshilltarëve dhe kryepleqve	2,000,000	
								30,925,647	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

01/11/24 12193/6

Nr. 644/prot.

Durrës, më 01.11.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.97 datë 28.10.2024, "Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 195, datë 22.12.2023, "Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

